



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 2006/prot.
11

Tiranë, më 10.03.2026

UDHËZIM

NR. 7, DATË 10.03.2026

PËR

**DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 12, DATË 30.06.2023, TË MINISTRIT TË
ARSIMIT DHE SPORTIT “PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe urdhrit nr.580, datë 11.11.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, Znj. Armela Baka”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 12, datë 30.06.2023, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, bëhen shtesat si më poshtë:

- a) Pas shkronjës “d” të pikës 1, të kreut X, shtohen shkronja “dh” si më poshtë:

“dh) Përjashtimisht për vitin akademik 2025-2026, kandidatët për student me diploma të huaja që regjistrohen në programe të përbashkëta studimi të arsimit të lartë, për të cilët vendi i origjinës ka ndryshuar kriteret e pranimit, kanë të drejtën të aplikojnë për regjistrim deri më datë 31 mars 2026.”.

- b) Pas pikës 2, të kreut X, shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 si më poshtë:

“2/1 Përjashtimisht për vitin akademik 2025-2026, për kandidatët e regjistruar në një program të përbashkët studimi të arsimit të lartë, për të cilët vendi i origjinës ka ndryshuar kriteret e pranimit dhe që kanë detyrimin për njohjen dhe njehsimin e diplomës së huaj, QSHA përfundon procesin e njohjes dhe njësimit të këtyre diplomave brenda datës 31.05.2026.

2/2 IAL-të përcjellin në QSHA, brenda datës 10 qershor 2026 dokumentet e njohjes dhe njësimit të diplomave të tyre, të lëshuara nga QSHA-ja.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimit, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR

ARMELA BAKA

